




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Doretuar Punigjendur/Prodato Received/Delivered	02.12.2021	1	viti god year
Organifjësia Organ /Jedinita Org /Unit	Nr Prot Pr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMSHOK	5782/2021		1/5



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.957/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyl Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.81/20 të datës 19.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë rishqyrtuar ankesën me numër A 02/563/2015 të datës 30.11.2015, të parashtruar nga

Judex, me adresë: Rr. B C 15/10 Nr.3 në Prishtinë, kundër Ministrisë së Shëndetësisë, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 02.12.2021 mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET si e pa bazuar** ankesa me numër A 02/563/2015 të datës 30.11.2015, të parashtruar nga ankuesit: \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ të regjistruar me numër A.nr.688/2019 sipas Aktgjykimit A.nr.1892/19 të datës 08.10.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

### A r s y e t i m

Ankuesit, \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ të punësuar sipas aktë emirimeve të bashkëngjitura në shkresat e lëndës në Ministrinë e Shëndetësisë me datë 26.12.2013 me numër protokoll 7710, kanë parashtruar kërkesë për aprovimin e shtesave për shkak të specifikave të vendit të punës tek Sekretari i Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, në Ministrinë e Shëndetësisë, sikurse shihet në shkresat e lëndës me datë 07.03.2014 me numër protokoll 05-1414 Udhëheqësi i Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, në Ministrinë e Shëndetësisë, parashtron kërkesë për shtesa në paga, tek Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Administratës Publike, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të

Qeverisë së Kosovës, për pozitat deficitare dhe shtesa. Ankuesit me datën 10.06.2015 me numër protokollit 05-3295 kanë përsëritur kërkesën për aprovimin në pagën bazë dhe pasi që nuk kanë marrë përgjigje lidhur me kërkesat e parashtruara, me datën 16.10.2015 me numër protokollit 05-5799/2, kanë parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, në Ministrinë e Shëndetësisë, si dhe në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Administratës Publike.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Ministrisë së Shëndetësisë edhe për kundër obligimit ligjor për të marrë vendim, një gjë të tillë nuk e ka bërë, në kuadër të afatit ligjor të paraparë.

Përfaqësuesi i autorizuar i ankueseve me datë 30.11.2015 ka parashtruar ankesën, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokollit 4247/2015, pas heshtje administrative të organit të punësimit, me pretendime ankimore për zbatimin e vendimit të qeverisë Nr.02/39 të datës 08.10.2008 dhe ankuesve t'ua ndajë në mënyrë retroaktive shtesat nga hyrja në fuqi të vendimit të qeverisë Nr.02/39 të datës 08.10.2008.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 25.01.2016 ka nxjerr Vendim A/02/563/2015 me të cilin ka hedhë poshtë si të palejuar ankesën e datës 30.11.2015 të ankuesve. Ankuesit kundër këtij vendim kanë parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 09.10.2018 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.286/16 me të cilin ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësve. Ankuesit kundër këtij aktgjykimi kanë parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës. Gjykata e Apelit e Kosovës më datë 22.07.2019 ka nxjerr Aktgjykim AA.nr.619/2018 me të cilin ka aprovuar ankesën e paditësve duke e prishur aktgjykimin e shkallës së parë dhe duke e kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje lëndën në gjykatën e shkallës së parë. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 08.10.2019 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1892/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve duke anuluar vendimin A/02/563/2015 të Këshillit dhe duke e kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesve, ndërsa më datë 10.12.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesit për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës, duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesit ka ndjekur procedurat duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 19.11.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.81/20 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 10.12.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesve.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova:** Ankesën me numër protokoll 4247/2015 e datës 30.11.2015 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Shkresën e datës 10.06.2015 nga ankuesit; Kërkesën për shtesa në pagë e datës 07.03.2014 nga Udhëheqësi i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme; Kërkesën për aprovimin e shtesave në pagën bazë e datës 24.12.2013 nga ankuesit; Shkresën për kompensimin për shtesa retroaktive e datës 12.06.2013; Kërkesën për përfshirje në listën e shtesave e datës 22.07.2013; Shkresën për Aprovimin e pozitive dhe shtesave në pagë për kategoritë e veçanta; Vendimin Nr.01/39 i datës 08.10.2008 i Qeverisë së Kosovës; Vendimi Nr. 02/39 i datës 08.10.2008 i Qeverisë së Kosovës dhe Aneksi I; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 24.12.2015; Përgjigjen në kërkesë e datës 06.01.2016; Akt Emërimin për ankuesen

Shkresën për procedim të lëndës në komisionin e ankesave e datës 16.10.2015; Ankesa e datës 15.10.2015 e parashtruar nga ankuesit në Komisionin e Ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë; Autorizim i datës 12.08.2015; Struktura Organizative SISH; Detyrat dhe Përgjegjësit e pozitive të ankuesve; Vendimi A/02/563/2015 i datës 25.10.2016 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin A.nr.81/20 i datës 19.11.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Kërkesë për vendosje e datës 25.03.2019 nga ankuesit; Aktgjykimin A.nr.1892/19 i datës 08.10.2019 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykimin AA.nr.619/2018 i datës 22.07.2019 i Gjykatës së Apelit të Kosovës; Aktgjykimin A.nr.286/16 i datës 09.10.2018 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Përgjigje në padi e datës 13.07.2018; Aktvendimin A.nr.286.16.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesve, **është e pa bazuar sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosje e ankesave, gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesve, ka analizuar Vendimin Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes të cilit është aprovuar lista e pozitive dhe shtesave në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare në fushën e teknologjisë informativë dhe inxhinieringut, dhe Vendimin Nr.07/29 të datës 31.07.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin është përcaktuar procedura për parashtrimin dhe trajtimin e kërkesave dhe mënyra e realizimit të shtesave për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare, dhe rrjedhimisht është konstatuar se aprovimi i shtesave në pagë për pozita deficitare është bërë me qëllim të ruajtjes së kategorive të veçanta deficitare të punonjësve, stimulimit të konkurrimit për profesione të veçanta deficitare dhe zbatimit të parimit të pagesës së njëjtë për punë të njëjtë në të gjitha organizatat buxhetore. Po ashtu, me këtë vendim është përcaktuar se paga bazë së bashku me shtesat mbi pagë nuk mund të tejkalojnë pagën e zyrtarëve të lartë të emëruar nga KELP-i, si dhe është obliguar Ministria përgjegjëse për Administratë Publike dhe Ministria e Financave për shqyrtimin e listës dhe standardëve kualifikuese dhe shumës stimuluese për postet e caktuara, së paku një herë në gjatë muaj.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 13.05.2010 ka aprovuar Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përmes të cilit është bërë përcaktimi i sistemit dhe strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, ndërsa me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji është përcaktuar se: **1. Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut.** Përkritazi me këtë, duke u bazuar në dispozitat e nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, Qeveria e Republikës së Kosovës,

me datë 24.12.2012 ka aprovuar Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përmes të cilës ka përcaktuar kushtet dhe procedurat për shtesat dhe kompensime të tjera mbi pagën bazë të nëpunësve civilë. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore janë shfuqizuar të gjitha aktet nënligjore të cilat kanë rregulluar shtesat dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil, dhe rrjedhimisht janë SHFUQIZUAR edhe Vendimi Nr.02/29 i datës 31.07.2008 dhe Vendimi Nr.02/39 i datës 08.10.2008 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, konstatim ky i dhëne edhe në Raportin Vjetor të Vitit 2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që duke u bazuar në këtë konstatim. Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesve për realizimin e shtesës në pagë sipas Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është i pa bazuar, sepse ankuesit pretendimin ankimor e bazojnë në akte juridik të cilët në kohën e paraqitjes së ankesës dhe kërkesës në Ministrinë e Shëndetësisë tashmë ishin të shfuqizuara dhe pa afekte juridike.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 8 të kësaj rregullore, ka arritur të konstatojë se Ministria përgjegjëse për administratë publike, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financa, mund të kërkojë nga Qeveria që të miratojë një shtesë për kushtet e tregut për pozitat ose llojet e pozitave për të cilat niveli i pagës për personelin e ngjashëm nga organizatat dhe punëdhënësit e tjerë jashtë Shërbimit Civil është së paku 40% më i lartë sesa niveli i pagës që ofrohet nga Shërbimi Civil, e kjo shkakton vështirësi të konsiderueshme në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit të kualifikuar për ato pozita ose lloje të pozitave në administratë publike, ndërsa institucioni për realizimin e shtesës për kushtet të veçanta të tregut duhet t'i ofrojë Ministrisë përgjegjëse për administratë publike kërkesën lidhur me arsyeshmërinë e realizimit të shtesës dhe një analizë që dëshmon vështirësitë të cilat janë hasur nga institucioni gjatë rekrutimit dhe mbajtjes së personit të kualifikuar, listën e pozitave përkatëse dhe koston vjetore të vlerësimit financiar. Shtesa mbi pagën bazë për kushte të veçanta të tregut nuk mund të tejkalojë më shumë se 50% të pagës bazë.

Prandaj Kolegji si rrethanë faktike dhe ligjore për refuzimin e ankesës ka marr faktin se pretendimi ankimor i ankueseve është bazuar në dy vendime të Qeverisë së Republikës së Kosovës të cilët në kohën e parashtrimit të kërkesës dhe ankesës kanë qenë të shfuqizuara nga Rregullorja Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 në paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.957/2021

Avdyll BEKTESHI

  
Procesmbajtës

Eshref SHABANI

  
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesve firmës së avokatisë
- Gjyqtares GJTH-Prishtinë
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

